



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 27.1.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Myrvete Pantina, Berat Luzha, , Hestet Cakolli, Elhëme Hetemi, Ibrahim Selmanaj, Ali Lajçi.

Munguan : Dragisha Miriç, Zef Morina, Selvie Halimi, Zulfi Merxha.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Blerim Vela dhe Maria Berishaj-OSCE, zyrtarët nga MMPH: Nezakete Hakaj dhe Nazmi Shkodra si dhe nga MBPZHR Tahir Ahmeti, Ismajl Hetemaj etj.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu

Mbledhjen e kryesoi : **Ibrahim Selmanaj**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,**
- 3. Programi për zhvillimin e sektorit pyjor.**

Deri në orën 13,40 komisioni nuk kishte kuorum për të mbajtur mbledhjen, megjithatë anëtarët prezent dëgjuan informatën e përgatitur nga ana e zyrtarëve të MBPZHR lidhur me **programin e zhvillimit në sektorin pyjor.**

Tahir Ahmeti tha se me këtë draft strategji MBPZHR është munduar të përmbledhë të gjitha draftet e përgatitura deri tani me qëllim të implementimit të programit në sektorin pyjor, kahet e zhvillimit për 10 vite të ardhshme, mirëpo kërkohet edhe një përgjigje e mundshme nga ky komision lidhur me procedurat se a do të jenë në nivel të parlamentit apo vetëm në nivel të ministrisë. Me këtë program synohet eliminimi i gabimeve të gjertanishme përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve pyjore që të ketë përputhje me objektivin e përgjithshëm. Pasi që drafti më herët është dorëzuar me shkrim për tu njoftuar komisioni, zyrtarët e MBPZHR shprehën gatishmërinë për të dëgjuar komentet eventuale të anëtarëve të komisionit.

Elhëme Hetemi shprehu pajtueshmërinë me këtë draft të përgatitur ngase është mjaft përmbajtjesor dhe asgjë nuk realizohet pa strategji. Për këtë sektor ka mjaft shqetësime nga

popullata, ndaj me të drejtë kërkohen përmirësime në këtë fushë. Ajo shfaqti brengën se sa do të jetë afati për zbatimin e këtij programi. Reagoi zyrtari i MBPZHR duke theksuar se afati është 10 vjeçar.

Berat Luzha tha se ky program nuk ndryshon asgjë në esencë nga gjendja ekzistuese : gjendja shumë e vështirë në sektorin pyjor. Ai ilustroi këtë duke theksuar se zjarret, prerjet ilegale, vjedhjet dhe shkatërrimet e pyjeve nuk kanë të ndalur, ndaj apeloj dhe kërkoi që sa më urgjent të sjellët ligji i ri për Pyje. Nëse nuk hartohet ligji i ri, pse nuk hartohet ?. Kuvendi ka potenciale për të hartuar këtë ligj, por fillimisht këtë gjendje duhet të arsyetoi ministria e bujqësisë. Domosdoshme është të ndërpriten prerjet e pyjeve dhe të ndryshoi kjo gjendje.

Përgjigja nga zyrtarët e ministrisë së Bujqësisë ishte se grupi punues është formuar pranë zyrës së kryeministrit, ndaj brenda një muaji do të përfundoi hartimi i ligjit që kërkohet, por edhe që është domosdoshmëri. Ai tha se me ligjin e ri do të ashpërsohen dënimet dhe masat tjera për mbrojtjen e pyjeve.

Heset Cakolli konstatoi gjendjen shumë të rëndë që është krijuar me prerjen e pyjeve, ndaj apeloj që ligji i ri me masa konkrete duhet të jetë i aplikueshëm.

Myrvete Pantina u pajtua me Berat Luzhën sepse gjendja është e vështirë në këtë sektor, gjithashtu vërejtja e saj ishte se nuk është konkrete programi në fjalë. Sa më shpejt duhet të hyj në fuqi ligji në fjalë, përfundoi ajo.

Zyrtarët nga ministria u pajtuan se materiali është i mangët për mbledhjen e sotme, ndaj shpejt ai do të fuzionohet bashkë me koston financiare.

Ibrahim Selmanaj falënderoi mysafirët dhe i ftoi në bashkëpunim të mëtejshëm lidhur me këtë fushë të rëndësishëm.

Lidhur me dy pikat e mbetura të rendit të ditës, nënkryetari konstatoi mungesën e grupit punues lidhur me projektligjin në fjalë, ndaj me pajtimin e anëtarëve tjerë u shty mbledhja për javën tjetër.

Mbledhja përfundoi në orën 14,00.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli